

Specifikimet e Shërbimit

Situata e shërbimit të Pastrimit ne Nj.Administrative Guri Zi , Berdica dhe Ana Malit.

Bashkia Shkodër është duke organizuar tenderimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për NjA Guri Zi , Berdica dhe Ana Malit. Pra ky shërbim, ka përgjithsuar grumbullimin e mbeturinave të banorëve, bizneseve dhe transportin e tyre drejt landfillit të Bushatit. Ky shërbim do të vazhdojë të kryhet vetëm për këtë proces pune , pra grumbullim-transport-depozitimi mbetjeve urbane.

Prodhimi i mbetjeve

Elementi kryesor i llogaritjes së planifikimit është norma e prodhimit të mbetjeve.. Gjithashtu elementi i rëndësishëm për përcaktimin e sasisë ditore të mbetjeve është dhe numri i popullsisë. Në tabelën e mëposhtme po japim prodhimin mesatar ditor dhe vjetor të mbetjeve për njësitë administrative respektive .

Nj.Administrative	Banorë		Sasia e prodhuar e mbetjeve		
	Gj, Civile	Census	Norma kg/dite	Ton /dite	Ton /vite
Guri Zi	11800	8.700	0.38	3.34	1220
Berdica	9465	7.069	0.34	2.43	889
Ana Malit	5850	4.804	0.35	2.77	1013
T O T A L I				8 ton/dite	

Grumbullimi dhe transporti

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane përgjithson mbledhjen në një nivel të lartë cilësie të mbetjeve të ngurta urbane të këtyre njësiteve administrative.

Depozitimi i mbetjeve

Mbetjet do të depozitohen në Landfillin Bushat , nga secila prej njësiteve administrative. Gjithë sasia e depozituar do të shoqërohet me flete-peshoren përkatëse dhe emertës të njësisë që depoziton mbetjen , mbi bazën e së cilës

do behet dhe pagesa per kete ze pune.

Grafiku dhe frekuenca

Grumbullimi I mbetjeve do te realizohet dy here ne jave per sejcilen prej njesive, paradreke.

Grumbullimi do jete ne pikat e grumbullimit me kazane , per cdo njesi administrative si dhe ne pikat e paautorizuara, kjo sipas kerkeses se investitorit.

Shenim: Grafiku I perbashket i te tre njesive administrative do te hartohet ne bashkepunim, sipermarresi ,administratoret e njesive dhe specialisteve te Bashkise.

Mjetet e nevojshme per transportin e mbetjeve.

Bazuar ne llogaritjet e volumit te mbetjeve , numrit te kontaniereve si dhe te turneve te punes se mjetit nevojitet :

1-Makine teknologjike me kapacitet 10 ton

- Duhet **cop 1 (nje)** , e cila ka nje sistem ngarkimi te pershtatshem me kontanieret qe do te perdorim ne keto njesi administrative.

-Sistemi mekanik duhet te punoje vete , pa patur nevojten e puntoreve qe te ngrejne kontanierin per ta varur ne sistemin ngrites.

-Kontraktuesi duhet te kete te mundeshme nje makine tjeter teknologjike te ketij kapaciteti , 10 tonesh , per te zevendesuar ne cdo moment makinen qe mund te kene difekt.

Mirembajtja e kazaneve.

Sipermarresi eshte I detyruar qe gjate kohes se realizimit te kontrates , te

mbaje inventarin e kontanierve si dhe ne menyre sistematike te beje riparimin e atyre. te demtuar.

Demtimet kryesore te cillat duhet te riparohen nga sipermarresi jane: demtimi I rrotave, kapakut dhe dorezave si dhe deformimet ne trupin e kontanierit.

Cdo pike grumbullimi dhe kontanieret perkates duhet te pastrohen dhe te lahen te pakten nje here ne muaj.

Sipermarresi eshte I detyruar te zevendesoje apo shtoje numrin e kontanierve ne masen 10 % cdo vit kalendarik (21 cop). Kazanet do te sillen nga 7 cop per cdo 4-muaj dhe do shperndahen ne te tre njesit sipas miratimit nga Drejtoria e Sherbimeve.

Kontanieret te jene sipas specifikimebeve teknike , te xinguar 1100 litrash.

Klorifikimi I kazaneve.

Klorifikimi do te realizohet te pakten nje here ne jave ne te gjitha pikat e grumbullimit te mbetjeve urbane , afer kazaneve te grumbullimit.

“Edukimi Publik Mjedisor”

- Në termin “Edukim Publik”, do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i operatori i shërbimit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve ne burim, etj periudhës së kontratës.
- Operatori i shërbimit duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së operatori i shërbimit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Ky kontakt mund të realizohet si nëpërmjet mass-mediaeve ashtu edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese.
- Operatori i shërbimit duhet të mundësojë shpërndarjen e materialeve informative të paktën dy herë në muaj. Materialet informative duhet të jenë në formën, fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotje, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë banoret për tu bërë pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.
- Operatori i shërbimit duhet të sensibilizojë banorët nëpërmjet programit të edukimit publik mjedisor që të parkohet në përputhje me planin e ndryshimit të parkimit, në rrugë dhe ditë të caktuara, për të mundësuar fshirjen më me cilësi të këtyre rrugëve.

- Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të miratohet nga Autoriteti kontratues.
- Në rast se kontraktuesi nuk permbush detyrimet e përmbushjes të edukimit mjedisor apo plotësimit të pjesëshëm të tij aplikohen gjoba ne masen 10.000(dhjetemije) leke/muaj.

Monitorimi

- **Supervizoret e bashkisë** kontrollojnë shërbimin e dhënë nga kompania dhe raportojnë:
 - Verifikojnë cilësinë dhe sasinë e shërbimit të ofruar nga kompania (kontenierë jo të grumbulluar, rrugë jo të fshira, kontenierë të dëmtuar, vende me grumbullim illegal mbeturinash...etj)
 - Rakordojnë vëzhgimet e tyre me përfaqësuesit e rajoneve, specialistët e njësive administrative
 - I japin informacion përgjegjësit të shërbimit në bashki dhe kompanisë për cdo parregullsi apo problematike ne lidhje me sasinë apo cilësinë e kontenierëve të pa grumbulluar, të pa disinfektuar, të pa larë dhe të dëmtuar apo edhe për rrugët e pa fshira si dhe për prezencën e pirqjeve të mbeturinave ilegale sidomos në zonën e plazhit (publik dhe privat).
 - Raportojnë cdo ditë tek përgjegjësi i shërbimeve në bashki në lidhje me sasinë dhe kualitetin e shërbimit të kryer nga kompania.
 - Ne rast se identifikohen zëra te shërbimit te pastrimit të porealizuar sipas preventivit të kontratës, supervizori në situacionin mujor bën ndalesën për shërbimin të pakryer, kjo përveç penaliteteve, sipas nenit perkatës.

Kompania private

- Kompania private është e detyruar që të mbajë cdo ditë statistika sipas pikave të mëposhtme dhe ti raportojë ato tek Pergjegjësi i shërbimit në bashki në formë elektronike dhe të printuar:
- Inventari mujor i të gjitha pikave të grumbullimit të përkohshëm të mbeturinave, si dhe gjendja fizike e tyre, zëvendësimet në rast të riparimit me datat përkatëse
- Numri i kontenierëve të larë dhe të riparuar ose I kontenierëve të humbur apo të dëmtuar
- Numri i kontenierëve të ngarkuar për cdo rrugë
- Koha e shpenzuar per grumbullim për cdo rrugë të realizuar (koha e nisjes së kamionit, koha e mbushjes së kamionit, koha e nevojshme per të shkuar në landfill, koha e shkarkimit në lendfill, koha e kthimit mbrapsht)
- Numri dhe intenerari i cdo makine, kilometrat e kryera nga cdo makinë transporti, nafta dhe vaji I konsumuar nga cdo makinë, si dhe operacionet e mirembajtjes per cdo makinë
- Lista e rrugëve dhe sipërfaqeve të fshira
- Sasia e mbeturinave të grumbulluara në zonën e plazhit / sipërfaqet e menaxhuara si dhe sasia e grumbulluar ne mënyrë të diferencuar cdo javë
- Lista e punëtorëve dhe e orëve të punës

Penalitetet

- Mos mbledhja e mbeturinave apo lënia e disa pikave të grumbullimit të pa mbledhura
 - Duhet që kompania të grumbullojë të gjitha pikat e përkohshme të grumbullimit sipas frekuencës së kërkuar dhe të përcaktuar në ToR. Supervizori i bashkisë pasi të bëjë monitorimin duhet të raportojë tek drejtori i shërbimeve në bashki, në qoftë se grumbullimi dhe largimi i mbeturinave nuk është bërë në përputhje me skedulen e dakortësuar dhe firmosur si nga bashkia ashtu edhe nga kompania private.
 - Në raportin e supervizorit duhet të përmendet ora e supervizimit dhe të gjitha parregullsitë në zbatimin e procedurave të grumbullimit duke evidentuar dhe numrin e kontenierëve të pa grumbulluar për atë turn.
 - Në rast të kontenierëve të pa grumbulluar atëherë kompania do të gjobitet me 5 fishin e kostos së grumbullimit dhe transportit të një kontenieri për çdo kontenier të pa grumbulluar.
- Riparimi i kontenierëve të dëmtuar dhe zëvendësimi i tyre në pikat e përkohshme të grumbullimit
 - Kontenierët e dëmtuar duhet të zëvendësohen me kontenierë të rregullt. Është në interesin e kompanisë që të mos ketë kontenierë të dëmtuar, gjë e cila do të rriste kostot e grumbullimit.
 - Është detyra e supervizorëve të bashkisë të identifikojnë dhe të raportojnë tek kompania numrin e kontenierëve të dëmtuar të cilët duhet të zëvendësohen dhe të riparohen. Nuk duhet të lejohet që numri i kontenierëve të dëmtuar të jetë më shumë se 3% e totalit të numrit të kontenierëve (8 copë) përgjatë një jave raportim.
 - Nëse kompania nuk i tërheq për t'i riparuar dhe nuk i zëvendëson këta kontenierë të dëmtuar me kontenierë të tjerë brenda një jave që nga momenti kur ata raportohen si të dëmtuar atëherë ajo do të penalizohet me 5 fishin e cmimit të menaxhimit të kazane për të gjithë kontenierët e dëmtuar për të gjithë periudhën që ata nuk janë riparuar.
- Mos larja dhe mos disinfektimi i kontenierëve
 - Duhet që kompania të garantojë larjen dhe dizinfektimin e të gjithë kontenierëve sipas specifikimeve të kësaj kontrate.
 - Supervizori i bashkisë pasi të bëjë monitorimin duhet të raportojë tek drejtori i shërbimeve në bashki, në qoftë se shërbimi i larjes dhe dizinfektimit nuk është bërë në përputhje me skedulen e dakortësuar dhe firmosur si nga bashkia ashtu edhe nga kompania private.
 - Në raportin e supervizorit duhet të përmendet dita dhe ora e supervizimit si dhe numri i pikave të përkohshme të grumbullimit apo sasia e kontenierëve të pa larë apo disinfektuar.
 - Në qoftë se numri i kontenierëve të pa pastruar brenda muajt është 3% e sasisë totale të kontenierëve (afërsisht 8 kontenierë) atëherë kompania do të gjobitet me 100 fishin e kostos së larjes dhe dizinfektimit të një kontenieri për çdo kontenier të pa larë dhe të pa

disinfektuar.

- Hedhja e mbeturinave në vende të tjera, jo në ato të përcaktuara nga bashkia (landfilli Bushat)
 - Kompania duhet të depozitohet mbetjet në landfillin e Bushatit. Ajo duhet të raportojë sasi të ditore dhe mujore të rrugëve dhe sasisë së mbeturinave të depozituara në landfillin e Bushatit.
 - Është detyra e supervisorëve të bashkisë të kontrollojnë dhe të raportojnë në lidhje me këtë aktivitet të kompanisë që ofron këtë shërbim. Në rast se identifikohen shkarkime të kamioneve të kompanisë në pika të paautorizuara nga Bashkia, atëherë kompania do të penalizohet me një gjobë prej 1.000.000 lek. Gjithashtu ajo duhet që të grumbulloj, ngarkoj, pastroj dhe të transportoj të gjitha mbetjet e depozituara në mënyrë të parregullt drejt landfillit të Bushatit me kostot e veta.

- Mos fshirja e rrugëve
 - Kompania duhet të fshijë të gjitha rrugët e përcaktuara në kontratë sipas frekuencave dhe orareve të dakortësuara në kontratë.
 - Nëse ky shërbim nuk realizohet qoftë sipas frekuencës së përcaktuar, orarit apo cilësisë së dëshiruar në ndonjë prej rrugëve të përcaktuara në kontratë, atëherë kompania do të penalizohet me 5 fishin e cmimit mujor për fshirjen e rrugëve.
 - Në rast se do të evidentohen hedhje të mbeturinave që vijnë nga fshirja (llumi apo sasi dherash, gjethe apo mbetje nga kopshtet) të depozituara në kunetat e kullimit atëherë kompania do të gjobet me një shumë prej 50.000 lekësh si dhe do të detyrohet të bëjë çbllokimin e tyre dhe depozitim të këtyre mbetjeve në kontenerët më të afërt.

- Mungesa e raportimit ose realizimi i tij në mënyrë të gabuar
 - Kompania është e detyruar të paraqesë raporte të detajuara mujore me të dhëna statistikore në lidhje me të gjitha operacionet që ajo realizon si obligim i kësaj kontrate. Kështu kompania duhet të raportojë në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e konteniereve, grumbullimin e mbeturinave nga zona e plazhit, grumbullimin e diferencuar të rrymave të vecanta, larjen dhe disinfektimin e konteniereve, transportin e mbeturinave me të gjitha mjetet e transportit, depozitim të mbeturinave në landfillin e Bushatit si dhe fshirjen e rrugëve.
 - Të gjitha raportet duhet të përputhen me punën dhe volumet e kryera në realitet nga kompania.
 - Raporti duhet të hartohet brenda dy javëve të para të muajt pasardhës dhe duhet t'i dorëzohet supervisorit të bashkisë.
 - Supervisorit të bashkisë duhet të bëjë kontrollin e raportit me të dhënat që ai ka nga situacionet ditore si dhe me të dhënat e marra nga landfilli i Bushatit. Për çdo raport të munguar apo të vonuar apo me të dhëna jo të sakta do të shoqërohet me një gjobë e cila është një reduktim prej 3% të situacionit mujor që duhet t'i paguhet kompanisë.

Detyrimet e veçanta të kontraktuesit.

-Kontraktuesi duhet te paraqese stafin dhe punonjesit per realizimin e kesaj sipermarje, si dhe me nje autorizim zyrtar te paraqese personin pergjegjes per realizimin e kontrates.

-Te kete kontrate paraprake me landfillin Bushat per depozitimin e mbetjeve.